



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 10580 prot.

Shkodër, më 06.05. 2026

**VENDIM**

**Nr. 40, datë 30.04.2026**

**PËR SHITESË NË BUXHETIN E VITIT 2026, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E  
KËSHILLIT BASHKIAK NR. 84, DATË 18.12.2025 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT  
TË VITIT 2026 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR  
2026–2028 TË BASHKISË SHKODËR”, I NDRYSHUAR**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.04.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 54, shkronja “dh”, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”; VKM-në nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; VKM-në nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, i ndryshuar, neni 3, pika 3.1, shkronjat “a”, “b” dhe “dh”; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; shkresën nr. 429/6 prot., datë 15.04.2026 “Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, të Ministrisë së Mbrojtjes, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, “Dërgohet miratimi për shpërndarjen e fondit për emergjencat civile, viti 2026”; VKB-në nr. 84, datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026–2028 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar, si dhe në dokumentacionin e përgatitur nga administrata e bashkisë,

## VENDOSI:

1. Të miratojë shtesën e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për vitin 2026, të alokuar në programin 10910 “Emergjencat Civile”, artikulli 231 dhe artikulli 604, në vlerën 21 847 320 lekë, e detajuar si më poshtë:

a) Për programin 10910, artikulli 231, me kod produkti 21AD502 – “Investime të Bashkive për Mbrojtjen Civile”, vlera e përlogaritur është 10 923 660 lekë.

b) Për programin 10910, artikulli 604, me kod produkti 91707AB – “Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme”, vlera e përlogaritur është 10 923 660 lekë.

2. Të miratojë programin 10910, artikulli 231, për marrjen e masave parandaluese, “Investime të Bashkive për Mbrojtjen Civile”, me kod produkti 21AD502, në vlerën 10 923 660 lekë, si më poshtë:

a) Ndërtimin e mbështetëseve bregore (shpatullave) dhe mbështetëses së ndërmjetme të Urës së fshatit Kir, si dhe të Urës së Mgullës.

<b>Institucioni Likuidues</b>	<b>Emërtimi i Aktivitetit</b>	<b>Shpenzime Kapitale të trupëzuara (231)</b>	<b>Plani 2026</b>
<b>Bashkia Shkodër</b>	<b>21AD502 Investime të Bashkive për Mbrojtjen Civile “Ndërtimin e mbështetëseve bregore (shpatullave) dhe mbështetëses së ndërmjetme të Urës së fshatit Kir si dhe Urës së Mgullës “ Totale e ndarë në :</b>	<b>10,923,660</b>	<b>10,923,660</b>
	Zbatim	10,606,337	10,606,337
	Supervizim	292,735	292,735
	Kolaudim	24,588	24,588

Qëllimi i këtyre investimeve është krijimi i bazës së nevojshme infrastrukture për vendosjen e urave tip “Bailey” nga Komanda Mbështetëse e Xhenios, në funksion të garantimit të kalimit të sigurt dhe të pandërprerë. Ndërtimi i mbështetëseve bregore (shpatullave) dhe i mbështetëseve të

ndërmjetme synon sigurimin e qëndrueshmërisë strukturore të veprës, si kusht i domosdoshëm për montimin e strukturës metalike të urës. Këto ndërhyrje do të përmirësojnë aksesin, lidhjen e zonave të prekura dhe mundësinë e reagimit të shpejtë të shërbimeve emergjente dhe të komunitetit lokal.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 39 vota

Vota Pro	39
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	04.05.2026

**SEKRETARE**

**Sabina Danaj**

